



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:201170

Datë: 07.02.2023

Numri i dokumentit: 03947141

P.nr.183/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdijaj dhe bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit F. I., nga Skenderaj, Rr.”...”, për shkak të veprës penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.1782/2022, të datës 13.09.2022 (2022:0061168), plotësuar me datë 20.10.2022, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 07.02.2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm **PP-II.nr.1782/2022, të datës 13.09.2022**, dhe gjykata e jepë këtë :

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **I pandehuri F. I.**, nga babai I. dhe nëna S., i vajzërisë S., i lindur me datë ... në Skenderaj, ku edhe tani jeton Rr.”...”, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i punësuar në Ndërmarrjen Publike “U., i gjendjes së mesme ekonomike.

- Ë S H T Ë F A J T O R -

- **SEPSE** : Prej periudhës së pavërtetuar e deri me datë 22.07.2022, në Skenderaj, në Rr.”...”, ku edhe gjendet shtëpia e të pandehurit, në mënyrë të paautorizuar është kyçur në rrjetin e ujësjellësit gjë e cila është konstatuar nga ana e punëtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovicë, pra duke mos

pasur autorizim nga furnizuesi ka marrë dhe me këtë ka përfituar dobi në shumën prej 175.77 Euro, duke e dëmtuar Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovicë.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet : 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 453 par.1, nenit 463 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të pandehurit i shqipton :

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej Dyqind (200.00) Euro të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20.00) Euro si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar – Kompanisë Regjionale të Ujësjellësit Sh.a-Mitrovica, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar material në lartësi prej njëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e shtatë (175.77) Euro.

A r s y e t i m

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 30.09.2022 ka paraqitur aktakuzën e saj PP-II.nr.1782/2022, të datës 13.09.2022, plotësuar me datë 20.10.2022, kundër të pandehurit F. I., nga Skenderaj, Rr."..."", për shkak të veprës penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit t'i shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor,

me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

- Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale në fjalë si : Kallëzimi penal i Kompanisë Regjionale të Ujësjiellit Sh.a-Mitrovica Nr... i datës 29.08.2022, Procesverbali i Kompanisë Regjionale të Ujësjiellit Sh.a-Mitrovica Nr.serik ... i datës 22.07.2022, Procesverbali mbi marrjen në pyetje për të pandehurin – F. I. Nr.KT-II-br... i datës 18.10.2022, lëshuar nga Policia e Kosovës DRP - Mitrovicë Jug, Stacioni Policor Skenderaj, Fatura Nr... i datës 14.09.2022, e Kompanisë Regjionale Ujësjiellit Sh.A Mitrovica, Fletëdeponimi i lëshuar nga Bankës për Biznes e datës 26.07.2022, Urdhëresa Nr... (pa datë) i Kompanisë Regjionale Ujësjiellit Sh.A Mitrovica, si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-**Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së**, : ngase i njëjti prej periudhës së pavërtetuar e deri me datë 22.07.2022, në Skenderaj, në Rr.”...”, ku edhe gjendet shtëpia e të pandehurit, në mënyrë të paautorizuar është kyçur në rrjetin e ujësjiellit gjë e cila është konstatuar nga ana e punëtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit Mitrovicë, pra duke mos pasur autorizim nga furnizuesi ka marrë dhe me këtë ka përfituar dobi në shumën prej 175.77 Euro, duke e dëmtuar Kompaninë Rajonale të Ujësjiellit Mitrovicë, për çka gjykata gjeti se i pandehuri në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata mori parasysh dhe vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të njëjtin rrethanë lehtësuese gjeti, rrethanat e tij personale, ndërsa rrethanë rënduese në rastin konkret gjeti shkallën e përgjegjësisë penale të tij, andaj duke u bazuar në rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cekura si më lartë gjykata të pandehurit i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur me të drejtë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe

të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimin me të cilin gjykata e ka obliguar të pandehurin që t'ia kompensojë dëmin material palës së dëmtuar, në shumën e përcaktuar si në pikën -IV- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura si dhe nga të gjitha shkresat e lëndës, gjykata ka vlerësuar se kishte bazë të mjaftueshme për gjykim të plotë të saj.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 dhe nenit 495 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.183/2022 me datë 07.02.2023.

Bashkëpunëtorja profesionale,

Sandra Fazliu

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.